



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 2285 Prot.

Tiranë, më 07/06/2024

Lënda: Kërkesë për marrjen e masës disiplinore

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA

KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Baza Ligjore: Neni 63, pika 1 gërma d), dhe 65/1 pika 1 gërma a) dhe pika 6 gërma c) të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të ndryshuar.
Neni 3, gërma dh) dhe ë), neni 8, pika 2 gërma b) të Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Seanca Plenare e datës 06.06.2024 nisi me zhurma dhe bllokim të foltores nga deputetët e opozitës.

Disa nga deputetët cënuan rregullin duke zaptuar foltoresh si dhe nuk lejuan që seanca plenare të fillonte normalisht sipas rendit të ditës. Deputetët Flamur Noka, Gazmend Bardhi, Luan Baçi, Ervin Saliçani, Edi Paloka, i'u drejtuan foltores duke e bllokuar atë e duke mos lejuar vijimin normal të seancës. Edhe pas thirrjeve nga Kryetarja e Kuvendit për t'iu kthyer

normalitetit, përsëri deputetët mbanin foltoren e bllokuar duke detyruar Drejtuesen e Seancës të kërkonte pushim.

Me rifillimin e seancës deputetët Gazmend Bardhi, Flamur Noka, Edi Paloka, Ervin Salianji, Luan Baçi, i'u drejtuan foltores duke e bllokuar atë dhe duke mos lejuar zhvillimin e debatit në pikën e parë të rendit të ditës "Raporti Vjetor i veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit (ERRU)", debat i cili u kërkuar nga vetë deputetët e opozitës.

Deputeti Flamur Noka që në nisje pengoi zhvillimin e rregullt të seancës plenare duke mbajtur të bllokuar foltoren dhe mikrofonin. Deputeti ka përdorur disa herë fjalë të rënda fyese e kërcënuese ndaj Kryetares së Kuvendit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, të cilët mbajtën fjalën e tyre nga vendi për shkak të bllokimit të foltores.

Gjithashtu z. Noka i ndërpreu fjalën deputetit të Partisë Socialiste z. Nasip Naço dhe u konfliktua me punonjësën e sigurisë i cili ishte aty pranë.

Kryetarja e Kuvendit i tërhoqi disa herë vëmendjen z. Noka për sjelljen e tij duke i kërkuar që të riktheheshin në normalitet, por sjelljet e tij vijuan të jenë të njëjta, duke detyruar Kryetaren t'i japë masë disiplinore "përrjashtim nga seanca plenare".

Deputeti Gazment Bardhi me sjelljen e tij pengoi zhvillimin normal të seancës plenare duke mbajtur të bllokuar foltoren dhe duke mos lejuar drejtuesin e ERRU-së të mbante fjalën e tij. Gjithashtu z. Bardhi i'u drejtua Kryetares së Kuvendit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave me gjuhë jo parlamentare dhe fjalë fyese.

Këto sjellje të deputetëve të opozitës të cilat çënojnë dhe pengojnë zhvillimin e rregullt të seancës plenare, janë në shkelje të rëndë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kodin e Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë.

Nisur nga sa më sipër në mbështetje të Rregullores së Kuvendit; neni 63, pika 1 gërma d), dhe neni 65/1 pika 1 gërma a) të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si dhe në mbështetje të nenit 3, gërma dh) dhe ë), nenin 8, pika 2 gërma b) të Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, paraqesim kërkesën si më poshtë:

- Marrjen e masës disiplinore ndaj deputetëve Flamur Noka, Gazmend Bardhi, Luan Baçi, Edi Paloka dhe Ervin Salianji, sipas nenit 65/1 Të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

- Mbledhjen e Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën për vlerësimin e masës disiplinore.

DEPUTETËT :

1. Bedex Jona

2. TONI GORU

3. Shir Metaj

4. Glypresa Karmoj

5. EDUARD SHALSI

6. Berdyl Kolleku

7. Hatixhe Konomi